



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.554/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Faton Ademi dhe Rrustem Thaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Aleksandar Arsenijevic, kandidat për kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, nga subjekti politik GI Srpski Opstanak, paraqitur ndaj Vendimit të KQZ-së Nr.2133-2021 të datës 28.08.2021, për shkak të mos certifikimit për pjesëmarrjen në Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen me 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me 31.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.554/2021 i datës 29.08.2021, i parashtruar nga Aleksandar Arsenijevic, kandidat për kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, nga subjekti politik G.I. Srpski Opstanak, paraqitur ndaj Vendimit të KQZ-së Nr.2133-2021 të datës 28.08.2021 për shkak të mos certifikimit për shkak të mos certifikimit për pjesëmarrjen në Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen me datën 17 Tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 29.08.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Aleksandar Arsenijevic, kandidat për kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, nga subjekti politik G.I. Srpski Opstanak në të cilin pretendon se vendimi i ankimuar i KQZ-së, është në kundërshtim me Kodin Penal të aplikueshëm të Kosovës Nr. 06/L-074, Neni 93, paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 3, duke thënë "PASOJAT LIGJORE MUND TË PARASHIKOHEN VETËM ME LIGJ. Pasojat juridike të një dënimi NUK MUND të ndodhin kur vendoset gjoba për kryesin dhe për këtë arsye nuk mund të shkaktojë humbjen e të drejtave të caktuara. Në vazhdim të apelit theksohet se Aktgjykimi Përfundimtar Nr. 147/2018 në këtë rast nuk mund të prodhojë pasoja juridike për moskandidimin e Aleksandar Arsenijevic (gjithashtu akti i supozuar është kryer më 27 TETOR 2017, i cili mund të konfirmohet në dokumentacionin e dorëzuar anëtarëve të KQZ-së sa më shpejt të jetë e mundur me 28 gusht).

Kërkojnë nga PZAP-i që të marrin parasysh nënshkrimet e mbështetjes për kandidaturën. Si GI Srpski Opstanak, dhe se këmbëngulin që ky vendim të ndryshohet dhe që personit në fjalë t'i lejohet të marrë pjesë në zgjedhjet e 17 tetorit, në mënyrë që të merrë pjesë në mënyrë të barabartë dhe në formën e planifikuar në procesin zgjedhor. Sipas parashtruesit të apelit çdo vendim tjetër do të jetë në kundërshtim me të drejtat e garantuara me kushtetutë të çdo individi në Kosovë.

Parashtruesi i apelit krahas apelit ka bashkangjitur si dëshmi Vendimin e KQZ-së, për certifikimin e subjektit politik dhe një kandidati për Kuvend Komunal me numër protokoli

2134-2021 dhe Vendimin për moscertifikimin e kandidatit nga subjekti politik G.I. Srpski Opstanak, Aleksandar Arsenijovic.

PZAP-i me datën 29.08.2021 ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesën për përgjigje ne ankesë.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike ZRPPC-KQZ, ka dërguar përgjigjen në ankesë më datën 30.08.2021, në të cilën theksohet se sa i përket z.Aleksandar Arsenijovic, kandidat për kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, nga subjekti politik GI Srpski Opstanak, është kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që ti sigurojë KQZ-së, emrat e individëve nga lista e kandidatëve të subjektit politik GI Srpski Opstanak, të cilëve me anë të vendimit të gjykatës iu është hequr e drejta për të qenë kandidat apo që janë shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit.

Më datë 27 Gusht 2021, Zyra për certifikim, nga KGJK, ka pranuar shkresën me të cilën z. Aleksandar Arsenijovic, kandidat për kryetar të komunës së Mitrovicës së Veriut, është identifikuar se është i dënuar me Aktgjykim të Plotfuqishëm Pnr.147/2019 të datës 17.12.2018.

Mëtutje në përgjigjen e ZRPPC-së, theksohet se Zyra përmes personit kontaktues ka komunikuar me subjektin politik GISO duke e njoftuar për të gjeturat dhe duke i kërkuar që të njejtin ta zëvendësoj, në të kundërtën ai do të rekomandohet për moscertifikim të tij. Subjekti politik GISO, brenda afatit ligjor ka njoftuar se nuk do ta sjellë zëvendësimin dhe se do të atakon vendimin për moscertifikim të z. Aleksandar Arsenijovic, për shkak të mospërputhjes së aplikimit të tij me germën 'q' të nenit 29 të LZP-së.

Në vazhdim të përgjigjes theksohet se KQZ-së ka miratuar rekomandimin e Zyrës duke mos certifikuar kandidatin me datë 28 gusht 2021 me vendimin e KQZ-së nr.2133-2021.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj apelin, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoj lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-ja, lidhur me refuzimin për certifikimin e tij nga gara e listës së kandidatit për kryetar në komunën e Mitrovicës së Veriut, iu është bërë e padrejtë pasi që Aktgjykimi Përfundimtar Nr. 147/2018 në këtë rast nuk mund të prodhojë pasoja juridike për moskandidimin e Aleksandar Arsenijevic (gjithashtu akti i supozuar është kryer më 27 TETOR 2017, i cili mund të konfirmohet në dokumentacionin e dorëzuar në KQZ, paneli vlerëson se pretendimet e parashtruesit të apelit janë

të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, sepse neni 29 par.1 pika q) i LZP-së, përcakton se cilido person, emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i përshtatshëm për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit, siç edhe është në rastin konkret ngase parashtruesi i apelit me Aktgjykimin e plotfuqishëm P.nr 147/2018 i formës se prerë me datë 17.12.2018 me te cilin është shpallur fajtor.

Mbi këtë bazë, Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr.2133-2021 të datës 28.08.2021 drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 29 par. 1 pika q) të LZP-së, pasi që i njëjti është shpallur fajtor për vepër penale me aktgjykim përfundimtar në tri (3) vitet e fundit, sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm P.nr147/2018 i formës se prerë me datë 17.12.2018 dhe me këtë vendim nuk është certifikuar kandidati Aleksandar Arsenijevic nga subjekti politik GI Srpski Opstanak i rekomanduar nga ZRPPC, sepse nuk është bërë zëvendësimi me ndonjë kandidat tjetër, mirëpo në bazë të rekomandimit të ZRPPC-së, është certifikuar subjekti GI Srpski Opstanak dhe lista e këtij subjekti prej 1 (një) kandidati për kuvend komunal, sipas vendimit të KQZ-së me numër prot.2134-2021, dhe meqenëse i njëjti nuk është i përfshirë në listën e rekomanduar dhe nuk është zëvendësuar, çdo pretendim në apel mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm.

Fakti se parashtruesi i apelit pretendon se vendimi i marrë është në kundërshtim me Kodin penal, për Panelin rrethanat e tilla nuk krijojnë mundësi për përshtatshmërinë e kandidatit bazuar në kufizimet e përcaktuara në nenin 29 par 1 pika q) të LZP-së, nga se kjo dispozite ka përcaktuar tri kritere, që të jetë shpallur fajtor për vepër penale, që të jetë dënuar në tri vitet e fundit dhe që vendimi të jetë i formës se prerë, për pasojë në rastin konkret që të tri këto kritere ligjore plotësohen dhe shlyerja nga evidenca e të dënuarve ka efekt për të drejtat që janë humbur si pasojë e dënimit penal, ndërsa sipas LPZ-së, për tu certifikuar kandidati për deputet duhet shikuar vetëm se a plotësohen këto tri kritere ligjore nga neni 29.1. pika q) të LZP-së.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika b) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në pajtim me nenin 115.1 lidhur më nenin 118.1, 118.5 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 554/2021 më datën 31.08.2021.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.